

KOSOVARJA

Ballina: Fjolla Morina
Foto: Nehat Behrami
Veshja: Alayahluxury

**Kush po luan
me popull**

**Nxënësit
e gjimnazit
të Prishtinës –
haptazi
për seksin**

**Bir, eja shihe
nënë tënde
veç një herë**

**FJOLLA
MORINA**
histori në vete

**Perandoria
e estetikës
“VIP Nails
& Beauty”
nga Zvicra
në Gjakovë**

**Ç’thonë gratë
e martuara
për kohën
kur u bën nuse**

**Dikur
në jetimore
të Serbisë,
tash mis
i Kosovës**

ALAYAH
LUXURY STYLE

remos

eurokoha

SHERWOOD
Beauty and Nail

MARITIM
Beauty and Nail

CIMA
Cosmetics and Beauty

UB
UNION BUSINESS
ALBANISCH & DEUTSCH

DINO
CERAMICHE

Shkabaj
FISH FARM

MOLLA

Shkenda Dybesh
Desserts and Sweets

lanaderm

DENTFIX

allure



DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË

+383 44 206 586
www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, një game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; “mirage”, “azuvi”, “ecoceramic”

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.



NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME

ARMIQ
NDAJ
BAKTERIEVE

NUK
PËRBEJNË
ALERGJI

PASTROHEN
LEHTË

NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME



info@brezovicahotel.com
www.brezovicahotel.com





Zoti e bani llugë e Kosova u bë shtet!

Bajrami, nga Gadimja e Lipjanit, 70 vjeç, kurrë nuk është lutur për mirë. As në paqe e as në luftë. Thotë se Zoti i ka ndihmuar edhe duke u lutur mbrapsht. Kur dikush binte shahadet, në shenjë ndërgjegjësimi a pendimi, ai lutej për mbrapsht, me fjalët “Zoti e bëftë llugë”!

Ai nuk e ndërron lutjen e tij. Nuk e kishte ndërruar as kur e kishin zënë paramilitarët në mal, kur ia kishin vënë thikën në fyt. Një paramilitar i kishte folur shqip: “Lutu që të shpëtosh, po qe se do të jetosh!”.

E, Bajrami ia kthen: “Po, Zoti e baftë llugë!”.

Dhe, kur paramilitari sheh se ai nuk dorëzohej, e liron...

Edhe në vizitat për kryeshëndosh, ai sillej njëjtë, me të njëjtën lutje... Para Shpalljes së Pavarësisë së

Kosovës, u tha burrave:

“Pa e bërë Zoti llugë, as Pavarësia nuk do të vintel!”.

SI U SHPALL BAJRAMI NJERIU MË I MBRAPSHTË?

Një grup burrash të Gadimes së Lipjanit, si me tallje, vendosën që Bajramin ta shpallnin njeriun më të mbrapshtë.

Arsyetimi: Në Kosovë ka shumë njerëz të mbrapshtë, që luten çdo

ditë të ndodhë diçka e keqe. Njëri ndër ta është Bajrami i Gadimes së Lipjanit, i cili i ka vetëm dy kuaj dhe asgjë tjetër nga pasuria. Edhe ata të lodhtë shumë. Njëri kalë çohet vetë në këmbë, e tjetrit pak me i ndihmua çohet...

Një kohë edhe e kanë thirr në oda si pleqnar. Dhe, kur e kanë pyetur si arrin t’i pajtojë njerëzit, ka thënë: “Shumë lehtë. Të fortit gjithmonë i jap të drejtë, e fukaraja kur sheh se s’ka çka bën, thotë këtë punë po ua lë pleqve të vendosin vetë!”.

Në ballinë...

Fjolla Morina

histori në vete

Emri i Fjolla Morinës është vendosur me mijëra herë në krye të lajmeve rozë dhe jo vetëm. Fjolla është personazh që godet me muzikë, performancë që tejkalojnë pritshmëritë, stil unik, por edhe me ngjarjet e jetës private.

Nuk mund të ketë një personazh të dytë në industrinë e muzikës dhe shou-bizit vendor si Fjolla Morina, femër e zjarrtë, që nuk ndalon së bëri gjëra ashtu siç i thotë mendja e saj, për çka nuk pendohet asnjëherë.

E DRIDHI SHQIPTARINË

Muzikën e nisi qëkur ishte shumë e re, ndikuar fuqishëm nga dëshira e saj për t'u shfaqur, për të treguar se është këtu dhe mund të bëjë gjëra ndryshe.

Në kohën kur këngëtarët filluan ta tepronin me paraqitje komerciale, Fjolla zbarkoi në skenë e thjeshtë, thua jse gjithmonë e grimuar pak. Tiparet i kishte të rralla, andaj natyraliteti i saj ishte i pëlqyeshëm.

Dhe, pasi emri i saj bëri bujë në muzikë e media, Fjolla Morina bëri të ditur se kishte ndërhyrë në gjoks, duke i rritur përmasat, për çka u vendos direkt në qendër të vëmendjes.

Fjolla u bë këngëtarja e parë që i pranoi pa asnjë kompleks ndërhyrjet në trupin e saj, madje kurrë nuk u ndal së qeni e sinqertë.

E, krahas evoluimit të pamjes së saj, u gjallërua edhe karriera muzikore e bukuroshes, duke i shtuar krijimtarisë muzikore shqiptare hite moderne të njepasnjëshme.

"FB" ishte hiti që ndryshoi kursin e të bërit muzikë në vend, një këngë ndryshe, performancë e nxehtë dhe një standard i ri në treg. Fjolla u bë inspirim edhe për shumë vajza e këngëtare të tjera, të cilat më pas ndoqën thua jse të njëjtën vijë. Ndër

vite erdhën projekte të tjera, por "Trileqe", në bashkëpunim me "Elinel", u kthye në këngë virale një kohë të gjatë.

Ajo është dëshmuar disa herë edhe me balada dhe më e ndjeshme mbetet ajo me titull "Si ta pranoj", në bashkëpunim me Valon Bytyqin.

Goditja e fundit erdhi para një viti, kur këngëtarja tregoi se ka në dorë potencën për ta dridhur skenën dhe këtë e bëri me videoklipin e këngës "Kape", që është një prodhim i përmasave botërore, me një frymë të paparë në vend.

Ndërkohë, në të gjitha shkrimet e intervistat, gazetarët kanë tendencë që të vënë në pah jetën luksoze të këngëtares, udhëtimet, shëtitjet në vende mbresëlënëse, veshjet nga markat më prestigjioze etj.

"ALYAH LUXURY"

- VENDI

I VESHJEVE EKSKLUZIVE

Fjolla i ka vënë motorët në lëvizje edhe përmes biznesit të saj, butikut me emrin e vajzës së saj, "Alayah", ku ofrohen veshje për të gjithë me stil elegant, modern etj. Por, është e kuptueshme që aty mund të gjeni vetëm gjëra unike...

Në "Alayah Luxury" gjeni koleksion për gra, linjën e veshjeve luksoze për femra, për fëmijë nga 0-15 vjeç dhe për nëna. Mund ta vizitoni vetë, por edhe të bëni porosi online në faqen Alayah Luxury në "Instagram".

N. Neziri





Ç'bisedojnë tre pensionistë - Don Zhuan të Prishtinës?

Në çajtoren përballë Shkollës Filllore "Elena Gjika" në Prishtinë, dy pensionistët paksa më të rinj se unë, pothuajse çdo ditë kafënë e mëngjesit e pinë bashkë. E, ç'bisedojnë kur unë nuk jam aty nuk mund të di. Por, në këtë shkrim do e prezantoj muhabetin e bërë në njërën nga ndejat kur edhe unë isha me ta...

"Keq shumë. Shumë keq është në Veri të Kosovës. Njësia Speciale e Kosovës atje, Serbia me ushtri e armatim afër kufirit të Kosovës. E, ku ka me shku më keq?! Ende më rrinë në mendje skenat e luftës dhe ishalla nuk i përjetojmë edhe një herë...", thotë im shok, paksa më i ri se unë.

"Mos ma përmend luftën se trupi më rrëqethet sa herë që e dëgjoj fjalën luftë, sa herë që shoh ëndërr luftën, sa herë shoh film me përmbajte lufte!", i them unë, me qëllim që ta përmbylim këtë temë rrëqethëse.

"Po bre, po. Mirë e ke. Por, çka me i bë frikës", më thotë.

"Lëre, allahile këtë muhabet! Mbrëmë i dëgjova lajmet në televizion dhe Qeveria po u dhënka grave lehona nga 170 euro në muaj, shkaku i pandemisë. Thënë të drejtën, lajm shumë i mirë.

Por, a nuk jetojmë në pandemi edhe ne, të shkretit, pensionistët?! Qysh

more burrë kush një fjalë nuk e thotë për ne?! Ata të Shoqatës së Pensionistëve, me në krye njëfarë Sylejman Metën s'di çka bëjnë aty?! Kam përshlypjen se vetë i kanë punët mirë e për të tjerët shnosh!", them unë.

"Eh, tash ke ra në temë ku na dhemb neve, pensionistëve. Kurrë një fjalë kush nuk e thotë për ne: Si jetojmë? A kemi idare? A kemi para me ble barëra?", thotë im shok.

"Aiiii, alla hile, lëreni barërat se vetëm për sëmundje mendoni ju të dy!", ndërhyt në bisedë shoku ynë, më i ri nga ne të dy dhe vazhdon: "Unë nuk mendoj si ju për barëra. Nuk mendoj për idare, se idaren ta sjellë Zoti. Unë jam në luftë me vetveten se si, pas gjithë atyre femrave që kam pasur, tash jam pa asnjë! Edhe kështu nuk po bëka! Por, o jarani jem, po të ishe pak më i ri, si unë, do të gjeje ndonjë sa për me e hequr pak mërzinë!", më drejtohet mua.

"Eh, more dosti jem, më kanë kapluar hallet e jetës dhe as që më bie në mend se kam pasur dashnore ndonjëherë, e lëre më tash! Madje, nuk më bie në mend as dashnorja e fundit, e që nuk ishte moti...", i them unë.

"Keq, i përbuzëm! Tash këqyr në çfarë derexhe kemi ardhur! Jemi bërë për gjynah, me nga një makiato me orë të tëra rrimë në kafene!", ma kthen ai.

"Jo, nuk jemi bërë për gjynah. Por, atëherë ishte kohë tjetër... Por, hallet e jetës po e bëkan të veten...", i them, duke u munduar ta përmbyllë këtë temë.

"Po, po, fort mirë e ke. Hallet e jetës s'të lënë rehat askund, por edhe kështu, si jemi tash e si kemi qenë dikur, jemi bërë për gjynah!", ndërhyt shoku ynë, sikur i vë kapak kësaj teme. Dhe, pas një heshtjeje paksa të gjatë, duke u shikuar në sy, ngrihem dhe secili rrugës së vet, me hallet e veta...

Selim Rama

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

KUSH PO LUAN ME POPULL?

Për këtë temë, këto fjalë në këtë rubrikë, falënderoj komentuesit që paraqiten në portalet tona, me opinionet e të cilëve më nxitën të shkruaj një mënyrë të tillë. Mbase jo pak, këto fjalë kanë dozë pesimizmi, por ç'të bësh kur edhe vetë jeta, e përditshmja është bërë e papërbalueshme.

Çmimet "fluturojnë" nga dita në ditë. Madje, thonë se do të rriten ende... Kjo do të thotë se dikush pasurohet e dikush varfërohet në pafundësi...

Mjafton veç ky rast: Kryefamiljari i një familje të një fshati të Malishevës paralajmëron se do të bëjë vetëvrasje! Motivi: "S'kam bukë për darkë për gjashtë fëmijët e mi! Si ta pres të nesërmen?!".

A nuk mjafton kjo?

Eh, sikur t'ishte ky i vetmi rast në Kosovë... Kjo është ajo që në shumicën e qytetarëve dominon dëshpërimi, zhgënjimi...

Ja dhe një koment, të cilin e zgjodha në mesin e shumë komenteve të tjerë nga

portalet tona:

I nënshkruari "Kosova-SHBA", shkruan: "I vetmi investim në vend dhe për interes të Qeverive të deritashme ka qenë ndërtimi i burgjeve në Kosovë, e bile edhe me standarde evropiane, që do të jetë një "plus" për t'u anëtarësuar në BE. Kjo do të ndikojë shumë pozitivisht në shpejtimin e arritjes së pëlqimit për anëtarësim. Bravo Qeveri të shkuara! Jeni më të mirët! Mirupafshim në burgun bashkëkohor!".

*

Kanë, ndoshta, të drejtë ata që thonë se përditë jemi duke gropuar e hapur varre të vetvetes.

Çka po bëjmë për popullin tonë?

Çka po bëjmë për Kosovën?

E di se ka të atillë që s'pajtohen me këto fjalë jo vetëm t'mia. Do thonë se nuk është kaq zi, as kaq keq. Por, e di edhe se shumica do pajtohen, bile ata që jetojnë me 70 centë në ditë...

Gani Dili

Flamuri i demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë u ruajt qe 40 vjet në Shipkovicë të Tetovës

Para pak ditësh ishte dita më e veçantë për mua dhe shokët e mi të idealit, organizatorë dhe pjesëmarrës të demonstratave të vitit 1981 në Prishtinë dhe gjithandej në Kosovë. Pse?



Flamuri i kujtesës dhe krenarisë në duart e dy vajzave të mia, të cilat janë kujdesur për rikthimin e shkëlqimit të tij.

Pas dyzet vjetësh e kam gjetur Flamurin, i cili është valëvitur në këto demonstrata, të cilin nëna ime, tanimë e ndjerë, e ka fshehur të mos e konfiskojë policia, duke e qepur brenda palëve të një jorgani, pas arrestimit tim atëkohë, e frikësuar se do të bëjnë bastisje të përgjithshme në shtëpinë tonë gjatë ditëve në vijim. Pas shpërthimit të demonstratave nga studentët e Universitetit të

Prishtinës, më 11 mars 1981, shtypi zyrtar, organet e pushtetit dhe një pjesë e drejtuesve dhe profesorëve të Universitetit, dëshironin që këto demonstrata t'i paraqesin si revoltë e studentëve, protesta me karakter social, për ta fshehur karakterin politik dhe kombëtar të tyre, ashtu siç, vërtet, e kanë pasur ato. Këto tendenca i shfaqnin hapur edhe disa profesorë të Fakultetit Filozofik,

ku studioja unë, të cilët, kryesisht, ishin me orientim jugosllav dhe anëtarë të Partisë Komuniste. Këtë qëndrim janë munduar të na imponojnë edhe ne studentëve. Për këtë jam dëshmitar, sepse gjatë marshimit në ballë të këtyre demonstratave, më 11 mars, të parët që janë munduar të na bindin të heqim dorë nga kërkesat politike kanë qenë dy anëtarë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve

të Kosovës, prof. dr. Syrja Pupovci dhe prof. dr. Hajredin Hoxha, me të cilët kemi biseduar para Rektoratit të atëhershëm, në afërsi të RTP-së, të cilët me këmbëngule donin të na bindin, mes tjerash edhe për drejtimin e kolonës së studentëve demonstrues në sallën e sporteve "25 Maji", ku do të bisedonin me organet e Universitetit dhe përfaqësuesit e pushtetit për kërkesat tona "me karakter social", për standardin e studentëve dhe kushte më të mira për studime dhe jetë studentore.

Më 1 dhe 2 prill, këto demonstrata morën kahen e duhur, kur edhe u artikuluan hapur kërkesat tona politike, ndërsa pushteti i ashpërsoi masat e dhunshme dhe filloi me represalje, duke ushtruar terror mbi demonstruesit, studentët dhe qytetarët shqiptarë të Kosovës dhe viseve të tjera, që kërkonin hapur liri, barazi kombëtare dhe vetëvendosje, avancimin e statusit kushtetues politik të Kosovës, nga krahina autonome në Republikë. Më 1 prill, në orët pasdite, masa e mbledhur, studentë, punëtorë, qytetarë, nga Mensa e studentëve në drejtim të qendrës së qytetit, te Fakulteti Juridik/Ekonomik dhe SHLP-ja, kordonët e policisë e ndaluan kolonën e demonstruesve; ndërkohë që masa e demonstruesve po rritej gjithnjë e më tepër (me ardhjen edhe të punëtorëve të ndërmarrjes "Ramiz Sadiku" etj.), edhe radhët e forcave speciale të policisë forcoreshin dhe bëheshin gjithnjë e më agresivë ndaj demonstruesve.

Unë, nuk e di se çfarë kanë bërë të tjerët, të cilët ka vite që shkruajnë dhe shiten si organizatorë të këtyre demonstratave, por mbaj përgjegjësi për këtë që po shkruaj. Nuk më bëri përshtypje të duhur mënyra e organizimit, përderisa kishim kërkesa politike të qarta, kryesisht lidhur me statusin e Kosovës Republikë, nuk mund të ishin të qarta dhe të plota kërkesat tona pa Flamur kombëtar, siç ishte bërë praktikë në demonstratat me karakter të këtyllë kombëtar, nga lëvizjet çlirimtare kudo në botë. Përderisa masa e revoltuar vlonte në njërën anë, ndërsa në anën tjetër vërehesh nervozë e papërmbajtje në radhët e policisë (sigurisht me tyre kishte

edhe djem me dashuri në zemër për kombin, lirinë dhe Kosovën), thirra disa shokë që i njihja afër meje, për ta plotësuar këtë mungesë të Flamurit kombëtar në demonstratë, për t'ua dhënë karakterin e duhur.

Njërin nga flamujt që u sollën për pak çaste e kisha në banesën time (ky që shihni në fotografi, pas 40 vjetësh), ndërsa dy flamuj të tjerë i kemi marrë në banesën e shokëve të mi studentë, XH. M., nga Shipkovica e Tetovës dhe H. D., nga Dibra (janë dëshmitarë të gjallë), të cilët banonin atëkohë në "Rrugën e Sharrit", nr. 30 (shtëpia e Veli Tavërlanit), ku banonin edhe shumë studentë të tjerë nga Maqedonia. Njërin nga ata flamuj ia dhamë një punëtori nga Kombinati "Ramiz Sadiku", të cilin e lidhi me shpejtësi dhe e ngriti mbi bishtin e një kazme që mbante në duar, ndërsa tjetrin ia lidhëm për një shtize të improvizuar, purtekë nga një filiz i hollë që shkulëm nga ato që mbjellin shërbimet e qytetit për mirëmbajtjen e parqeve dhe pemëve gjelbëruese.

Dy flamujt që i morëm në banesën e shokëve të mi, ishin të sjellë nga Republika e Shqipërisë (sipas dimensioneve (1x1,5 m), më të vegjël se ata që përdorshin në Kosovë, Maqedoni dhe viset tjera shqiptare, me dimension më të madh (2x1m), që përdorshin zyrtarisht pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974.

Ky do të ishte një rrëzim i shkurtër për këtë Flamur. Uroj që Muzeu i Kosovës të ketë siguruar deri më sot ndonjërin nga këta flamuj (të tjerë nuk ka pasur në demonstratën e 1 prillit në Prishtinë, por sigurisht ka pasur në qytete të tjera dhe në ditë të tjera sa kanë zgjatur demonstratat e mëdha të vitit 1981 në Kosovë), nëse kanë aritur të mbrohen dhe ruhen në duart e demonstruesve, të cilëve u janë besuar atëkohë.

Njëri nga këta flamuj që ka vluar në ato demonstrata dhe është mbrojtur me forcë nga duart e policisë (siç shihet nga cepat e dëmtuar, jo nga vjetërsia), ka dashur fati të mbetet dëshmi e atdhedashurisë dhe sakrificës së brezit tim për lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës.

Akademik Abdulla Mehmeti

Nëna i bën thirrje djalit azilant...



Haxhire Gurakuqi

"Bir, eja e shihe nënë tënde veç një herë!"

*Haxhire Gurakuqi,
nënë e vetmuar në
strehën e të moshuarve,
i bën thirrje
të birit t'i kthejë sytë
kah ajo dhe ta vizitojë,
së paku, një herë
në jetë.*

Konfliktet në familje bënë që Haxhirja të siguronte vetë qiranë, ushqimet dhe nevojat e përditshme 20 vjet rresht, ndërsa para një viti e më shumë trokiti në derën e një institucioni privat për të moshuar për t'i kaluar vitet që i kanë mbetur.

Nuk dëshiron të japë shumë detaje, por me fjalë të shkurtra thotë se jeta është një luftë e pa fituar dhe shpreson që i biri një ditë ta takojë.

Haxhirja thotë se e falë djalin që e ka rritur e vetme qëkur ishte 7 vjeç. Ajo mbetet me shpresë se do e shoh qoftë dhe një herë të vetme të birin...

Pse regjimi i Enver Hoxhës e konsideronte armik Ibrahim Rugovën?

Presidenti Ibrahim Rugova konsiderohej “armik” nga regjimi enverist. Kështu thotë Kastriot Dervishi, i cili ka zbuluar një dokument të rrallë të vitit 1980.

Ibrahim Rugova i kishte zhvilluar në Shqipëri tri vizita: E para, nga 24 maj deri më 4 qershor 1971; e dyta, nga 26 maj 1974 deri më 7 korrik 1974 dhe, e treta, nga 15 mars 1980 deri më 13 prill 1980.

Herën e parë ai kishte qenë bashkë me Rexhep Ismajlin, duke qenë student i vitit të katërt dhe redaktor i revistës “Bota e re”.

Herën e dytë ishte ftuar nga Instituti i

Gjuhës dhe Letërsisë në Tiranë, kurse herën e tretë ishte ftuar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Shqipërisë.

Vizita e tij e tretë, nga 15 marsi 1980 deri më 13 prill 1980, edhe shënoi armiqësimin me regjimin komunist. Bashkëpunëtorë të regjimit, si “Dragoi”, raportonin se ai fliste keq për Shqipërinë socialiste.

Rugova u ndoq si objekti “Zdrukthi”. Citohej të kishte thënë: “Tani u binda përfundimisht se në Shqipëri nuk ka liri krijuese. Shkrimtarët janë shndërruar në burokratë. Krijuesve u jepen klishetë ku ata punojnë”.

Ndaj letërsisë së realizmit socialist flet me përçmim e përbuzje...

Në mars të vitit 1981, me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, Kadri Hazbiu, u urdhërua përpunimi i tij (ndjekja), duke e konsideruar “armik”.



Jetës nuk i dihet...



83-vjeçari nga Podujeva kërkon nuse?

Tri gra i ka ndërruar në jetë. Tash, edhe pse në moshën 83 vjeç, dëshiron përsëri të martohet.

Për tetë dekada me radhë u përball me sfida e humbje të mëdha në jetë. Bejtush Gjergji, ditë më parë humbi edhe bashkëshorten e tij të tretë. Nga ai moment, 83-vjeçari nga Podujeva, thotë se jeta e tij u bë edhe më e vështirë.

Atij i kishin vdekur tri gratë me të cilat kishte ndarë jetën. Me bashkëshorten e

tretë kishte një lidhje më të veçantë dhe për rrjedhojë thotë se edhe dashuria ishte më e madhe.

“U kanë ma e mirë e ma e re. 10 vjet u kanë ma e re se unë. Këtë unazë e kam me gruan e tretë kur e kom marrë. Këtë unazë nuk e hjek derisa të vdes”, shprehet ai.

Jetesa në vetmi është goxha e rëndë për të. Nga halli se do të vdesë i vetëm, thotë se nëse do të gjente një grua do të martohej sërish.

“Po me gjet e marr, po nuk më merr kërkush ma. Pare kam po nuk më vijnë kurgjo”, shprehet i mërzitur ai.

Fluturime direkte të sigurta dhe komode drejt Prishtinës dhe Shkupit. Rezervo tani!

Düsseldorf

« Prishtinë

Stuttgart

« Prishtinë

Frankfurt

« Prishtinë

Hannover

« Prishtinë

München

« Prishtinë

Hamburg

« Prishtinë

Zürich

« Prishtinë

Zürich

« Shkup

Basel

« Prishtinë



Easier way **to fly.**

flyksa.com

KOSOVA AIRLINES

eurokoha



Nxënësit e gjimnazit të Prishtinës *haptazi për seksin*

*Edhe pse kohë
pandemie, nxënësit
e shkollave fillore
dhe të mesme u
janë kthyer ban-
kave shkollore.*

*Disa kanë nisur me
përtesë, disa me
qejf, disa me lutje e
dëshira, e disa...*

Sipas profesorëve në Prishtinë, procesi mësimor po vijon normalisht. Ndërkaq, sipas nxënësve, edhe më tej nuk mungojnë zënkat, tollovia, kaosi...

Ishim aty nga kanë dal shumë gjenerata të njohurish, aty ku duan të jenë të gjithë - në Gjimnaz. E pritëm pushimin e gjatë, u përfshimë në turmë, takuam të rinj energjikë, të mençur, entuziastë, por edhe sish problematikë, të atillë që nuk e pëlqejnë "kodin shkollor".

Dëgjua muhabete, të qeshura, të shara, pamë teksa pinin duhan, teksa hanin bukë në dorë, teksa stërpikeshin me ujë. Pamë shumëçka...

Lolita, nxënëse që na ndihmoi t'i gjejmë ata që nuk përtojnë të flasin për revistën tonë, na tha se gjimnazi nuk është më ai i dikurshmi. Sipas saj, tash është "përzier leshi".

"Edhe në gjimnaz është pranuar gjithkush. Në kohën kur u shkollua nëna ime, të regjistrohesh në gjimnaz

ishite mburrje, ndërkaq tash nuk ka mbetur gjë as këtu", tha ajo.

Ajo bëri me dije se profesorët janë të ashpër, edhe pse djemtë shpesh i bëjnë të qeshin. U heqin karrigen, u bëjnë zile me "privat", gjuajnë me shkumës në klasë etj.

FLASIN HAPTAZI PËR SEKSIN...

Lolita, tutje tha: "Ka momente kur më vjen turp nga ato që i dëgjoj. Disa vajza flasin hapur për seks me djemtë e klasës, tregojnë se çfarë bëjnë me frajerat, e gjëra të tilla të ngjashme... Dhe, teksa ndahem nga Lolita, një grup vajzash e djemsh qeshin aq me të madhe, sa them: Qeshëshi gjithmonë!

Diturie Haxhaj

Si duket Zhade tash, e cila dikur na e rriti tirazhin e “Kosovares”?



Zhade tash

“Po kush nuk e mban në mend serialin brazilian “Kloni”, në të cilin aktorja kryesore rebelohej kundrejt zakoneve të vendit të vet dhe bie në dashuri me një turist të huaj?!

Seriali me vite mbajti para ekranit televiziv një numër të madh njerëzish, ndërsa aktorja kryesore, Giovanna Antonelli, e lindur më 18 mars 1976, në Rio de Janeiro, Brazil, arriti të bëjë për vete publikun. Shqiptarët “lanë kokën” pas saj dhe, me siguri, e kujtojnë edhe sot e kësaj dite, pavarësisht se kanë kaluar shumë vite nga shfaqja e fundit në ekranet tona.

E bukura e serialit, të cilën e kishin lakmi shumë vajza dhe gra në atë kohë, vazhdon të jetë e tillë. Aktorja tash është 45 vjeçe, por nga imazhet që ka publikuar duket shumë më e re.

Tash është aktore dhe producente e njohur.

Por, arsyeja pse e bëmë këtë shkrim për Zhaden është se në kohën kur shfaqej “Kloni” në televizionet tona, Revista jonë, “Kosovarja” nxori një shtojcë për aktorët e Serialit dhe shtija ishte shumë e madhe, sa edhe u detyruam ta rishtypëm një numër të konsiderueshëm ekzemplarësh.

Si u njoh Nexhmije Hoxha me "Tarasin"?



"Jeta e Nexhmije Hoxhës, me mbiemrin e vajzërisë Xhuglini, me siguri, do të kishte shkuar tërësisht ndryshe nëse nuk do të kishte marrë pjesë në mbledhjen e themelimit të Rinisë Komuniste më 23 nëntor 1941, ku merrte pjesë edhe Enver Hoxha..."

Në librin e saj "Përjetime dhe meditime në jetën time politike", Nexhmije Hoxha tregon njohjen me Enverin, takimin e parë me të, për të shkuar te jeta e përbashkët dhe zyrtarizimi i lidhjes natën e Vitit të Ri, në vigjilje të vitit 1945. Nexhmijen me Enver Hoxhën ("Tarasin") e kishte bërë Qemal Stafa, në mbledhjen e krijimit të Rinisë Komuniste, ku ishte anëtare edhe Nexhmije Xhuglini. Duket se aty nisi pëlqimi i parë, që më vonë u kurorëzua me martesë, me një ceremoni modeste e me një pajton të lodhur e kalë kockë e lëkurë, siç e përshkruan Nexhmije Hoxha.

SI U NJOH NEXHMIJA ME ENVERIN?

"23 Nëntori 1941 për mua është data që shënoi kthesë të rëndësishme në jetën time politike dhe personale. Vetëm dy javë pas themelimit të PKSH-së dhe nëntë ditë pas përfundimit të mbledhjes themeluese të Partisë, u thirr mbledhja për themelimin e Organizatës së Rinisë Komuniste. Kjo që një ngjarje e rëndësishme për jetën e vendit, por edhe për mua personalisht, pasi në të mora pjesë edhe unë, si përfaqësuese e vajzave dhe e të rejave komuniste e antifashiste. Isha e vetmja shoqe në këtë mbledhje, por edhe më e reja në moshë, nga 20 pjesëmarrësit. Kjo mbledhje e futi jetën time në një rrjedhë të re, sepse më përfshiu në jetën politike të partisë e të vendit. Aty u zgjodha anëtare e Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste, përkrah Qemal Stafës, Nako Spirut, Misto Mames etj. Por, 23 nëntori 1941 do të hynte në jetën time si një datë e shënuar edhe në aspektin personal, sepse në atë mbledhje, unë, vajza e re dibrane, do të njihja dhe do të takoja për herë të parë Enver Hoxhën, djaln nga Gjirokasta, i cili më vonë do të bëhej shoku im i jetës.

Si për çdo të ri dhe të re, edhe për mua një ngjarje e tillë që jashtëzakonisht e gëzueshme, pasi në zemrën time hyri një person, me të cilin do të lidhesha përgjithmonë. Kjo do të shënonte kthesën e dytë në jetën time, në aspektin personal dhe familjar. Ka mbetur i paharruar për mua çasti kur në dhomën e shtëpisë së Bije Vokshit, ku ishim mbledhur, hyri Qemal Stafa bashkë me të deleguarin e KQ Provizor të PKSH-së, të cilin Qemali na e prezantoi me emrin "Tarasi". Ashtu si të tjerëve, edhe mua më ra në sy shtati i tij i lartë, pamja e tij e hijshme, sytë e qeshur dhe të gjallë. E kisha parë atë fytyrë së largu, por në kushte krejt të tjera, në krye të demonstratës së 28 tetorit 1941, kur ai përleshej me milicët.

Ndërsa tani, në atë dhomë, ai erdhi midis nesh, na takoi një nga një, na shtrëngoi duart dhe këmbëzoi disa fjalë. Më pas e dëgjova me vëmendje dhe e ndoqa me sy tek na fliste në emër të KQ Provizor të PKSH-së me aq pasion, për lirinë dhe të ardhmen që synonim. Mua, si vajzë e re që isha, idetë e tij më zgjorin ëndrra, vegime të bukura dhe aspirata të reja, për të cilat ai na tha se do të bëheshin realitet.

"Tarasi" e shprehu hapur gëzimin që midis të rinjve në atë mbledhje merrte pjesë edhe një shoqe. Dhe, unë, pata rastin që, në pushimet që bënim, të bisedoja nga afër me të...

Në njërin nga pushimet, Enveri u afrua pranë meje dhe më përgëzoi për diskutimin që bëra në mbledhje. U ndjeva mirë, sepse e konsiderova një përkrahje dhe një inkurajim të posaçëm, sidomos për të rejtat, për vajzat, një vlerësim të forcës dhe të rolit të tyre në luftë dhe në shoqëri.

Sigurisht, të gjitha këto ndjenja dhe mbresa të mira për Enver Hoxhën atëherë ishin, thjesht, në kuadrin e faktit që njohja ime me të në mbledhjen e 23 nëntorit ndikoi drejtpërdrejt në aspektin personal dhe emocional të jetës sime".



Ç'thonë gratë e martuara për kohën kur u bënë nuse?

Dasma e sotme është larg vlerave shqiptare që ato mbartnin më parë. Një dasmë e konceptuar si një "mbrëmje argëtimi" mund të jetë gjithçka, por jo dasmë shqiptare, siç po ndodh tash...

CILAT VEÇORI TË DASMËS SHQIPTARE KANË HUMBUR?

Ka disa veçori që janë tipike shqiptare dhe kanë humbur. Për shembull, dasmat shqiptare nishnin disa ditë para dhe fillonin me ekspozimin e pajës së nuses, e cila u tregohej gjithë miqësisë; lyerja e gishtave të nuses me mjalte që i vendoste në portën e shtëpisë në momentin që hynte në shtëpinë e burrit etj., e që sot as që merret kush me to...

HEDHJA E PARAVE NË DASMË

Ky rit nuk është tradicional shqiptar, por është krijuar nga grupet orkestrante që vijnë në dasmë për të ftuar para. Kjo është një mënyrë tipike për të ftuar para, madje mund të konsiderohej si një imponim me dhunë.

Ka qenë më përpara e kufizuar vetëm si histori sporadike e të pasurve. Të pasurit kishin si të vetmen mundësi për të shpalosur pasurinë dhe nivelin e tyre, prandaj edhe hidhnin para në valle.

Ç'MUZIKË BËHET NË DASMA?

Dasmat janë kthyer drejt muzikës sl-lave, greke apo angleze. Madje, edhe kur këndohet shqip, këndohen këngë tallave!

E, në të vërtetë, kemi sa të duash këngë dashurie, por nëpër dasma dëgjojmë edhe këngë që s'kanë të bëjnë fare me dasmë...

PO VALLJA?

Nuk kanë lidhje fare me kërcimin tradicional. Këngët popullore i kërcëjnë si të ishin latine a turke. Nëpër dasma ka më shumë kërcime të huaja sesa shqiptare.

E, Ç'THONË TË MARTUARAT?

Fatime Dervishi, nga Gjakova, është martuar në ditët e demonstratave të vitit 1981 dhe që nga ajo ditë ka krijuar familjen e saj me tre fëmijë. Madje, ajo tashmë është gëzuar edhe me nip e mbesë, për të cilët duket shumë e lumtur, që në jetën bashkëshortore ia doli mbanë.

"Jam martuar në vitin 1981. Ishte koha e demonstratave në Kosovë. U martova në fshat. E unë, si qytetare, thënë të drejtën, nuk e doja fshatin, por burrin po.

Në dasmë morën pjesë të gjithë miqtë dhe fqinjët e burrit. Kështu martoheshim në atë kohë, me shumë miq e shokë, të ftuar e të paftuar.

Në ditët e para si nuse mbaj mend se më jepnin vetëm këshilla, hallat dhe tezet e mia, se si duhet të jetë nusja dhe çfarë duhet të bëj që të mos e turpëroj familjen e vajzërisë.

E, ato këshilla ishin: si duhej të sillesha në shtëpinë e burrit, çfarë duhej të bëja kur njerëzit këndonin ose kur t'më ngacmonin me fjalë që "si i lë prindërit" etj.

Duhej të mbaja kokën ulur si mesazh modestie, nuk duhej të lëvizja, por të qëndroja gjatë gjithë kohës në këmbë, sepse kjo ishte shenjë respekti për miqtë etj.



Nisja e dasmës bëhej që nga dita e mërkurë, ku fillonin me këngë defi. Ditën e enjte sillnin fustanet e nuses. Në grupin që përzgjidhej për krushq duhet të ishte në krye një burrë apo grua që dinte të mbante muhabetin. Burri nuk vinte me krushqit, siç ndodh sot.

Dera e shtëpisë rrinte e hapur 3-4 ditë për të gjithë të afërmit. Ndërsa tash të ftuarit shkojnë në restorant, në orarin që ua ka caktuar i zoti i dasmës.

Kur nusja dilte nga shtëpia duhej ta mbante babi për krahun ose dikush tjetër që e përcillte nusen.

Po ashtu, kur nusja dilte nga shtëpia e prindërve e hynte në derën e shtëpisë së burrit, duhet të kishte mjalte në duart e nuses dhe të vjehrrës, që të shkonin mirë dhe të kishte mbarësi.

Ushtaraku katolik konvertohet në mysliman që të martohet me shqiptare

Më 20 qershor të vitit 2006, në xhaminë "Hoxhë Sinan Pasha" në Kaçanik, nën udhëheqjen e ceremonisë konvertuese të efendi Florim Nezirajt, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut dhe në prani të Llokman Hoxhës dhe Bujar Dervishit, pranoi fenë islame kapiteni i KFOR-it, Bartolomiej Urban, i lindur më 1979, në Goldap të Polonisë, për të finalizuar martesën me vajzën shqiptare nga Runjeva e Kaçanikut.



Si rrallë kund, Kaçaniku ditën frymon më shumë me besimtarë sesa me dinamikë tregu dhe pune. Në qendrën e qytezës më historike të Kosovës, ku u shpall Kushtetuta e Kosovës më 1990, qëndrojnë krenare monumente dhe shtatore, besimtarë që kryejnë obligimet fetare në Xhaminë e Vjetër te qendra, pak lumit "Lepenc". Shtatorja e Sali Bajrës para objektit komunal të Kaçanikut dhe më tej në fund të qytezës salla e shpalljes së aktit të Deklaratës Kushtetuese të Kaçanikut. Përballë kalaja e vjetër që shpreh nevojën e renovimit dhe në qendër çajtoret e mbushura me qytetarë. Qyteza e Kaçanikut njihet edhe për të bëmat e saj në luftën e njohur "Lufta e Grykës së Kaçanikut", kur Dervish Pasha, më 1881, me afër 20 mijë trupa xhonturq, kishte marrë rrugën për ta shuar lëvizjen kryengritëse të Prizrenit, por duke lënë shumë të vrarë në Grykën e Kaçanikut. Dhe, gati 140 vjet më vonë nga kjo luftë,

në Kaçanik u bë një histori tjetër. Më saktë, ka ndodhur një martesë, e cila medialisht ka zgjuar kureshtjen e opinionit. Në fakt, kureshtja nuk u spikat si enigmatike vetëm se ishte martesë, por pse kaloi disa procedura, kryesisht të përmbushjes fetare myslimane, që ta kurorëzojë një dashuri të lindur mes dy vetëve: një ushtaraku polak që shërbente në "Bonstill" të Ferizajt dhe një femre shqiptare që ishte aty përkthyesë.

**Ç'THOTË
PROF. FLORIM NEZIRAJ,
KRYETAR I KËSHILLIT
TË BASHKËSISË ISLAME NË
KAÇANIK, NË KOHËN KUR E
VIZITUAM?**

Në xhaminë e Kaçanikut "Hoxhë Sinan Pasha", një i krishterë u bë mysliman në prani të kryetarit të Këshillit...

Është fjala e konfirmimit të një konvertimi në islam të ushtarakut Bartlomije Urban, e që mori emrin e ri Omer, pasi bëri martesë me Lumturie Kokën, nga fshati Runjevë e Kaçanikut.

Dhe, duke folur se si ka ndodhur tërë kjo, efendi Florim Neziraj, në kohën kur e vizitua, tha për revistën tonë, "Kosovarja", se konvertimi në islam i kapitenit Omer, që kishte shërbyer gjashtë muaj në KFOR, ka kaluar nëpër procedurë që ai me vetë dëshirë e ka pranuar fenë islame si fe të veten, duke hequr dorë nga feja e tij e deriatëhershme.

"Në zyrën e Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut, ushtaraku me kombësi polake, ka pranuar fenë islame si fe të veten, duke iu përmbajtur rregullave konvertuese islame", thotë imami Florim Neziraj.

E, ai realitet është realizuar pasi kapiteni polak është njohur me përkthyesen Lumturie Koka, nga fshati Runjevë i Kaçanikut dhe ka kërkuar konvertim.

Por, sipas rregullit islam, ai duhej paraprakisht të kishte kryer synetin te kirurgu dhe atë obligim e kishte përmbushur konfrom rregullave, e tek pastaj është kryer ceremonia e konvertimit të tij në islam, si dhe është bërë kurorëzimi.

ME MARTESE JANË PAJTUAR EDHE FAMILJA

"Në kuadër të rregullave shqiptare të martesës nuk kanë paraqitur asnjë pengesë familja e vajzës", thotë efendi Florim Neziraj dhe shton:

"Për këtë martesë është pajtuar edhe familja. Ajo që ne dimë është se familja e Lumturisë ka qenë dakord për martesë, duke i pranuar rrethanat e krijuara para, gjatë dhe pas konvertimit. Kur i kam pyetur pse po martoheni, ata më thanë se po martohen meqë pëlqehen të jetojnë si bashkëshortë, meqë i ka lidhur dashuria".

Ata jetojnë bashkë dhe ajo çka dimë është se jetojnë në Poloni...

Sokol Murturi

Pse janë të çuditshme femrat tona?

Me tim shok të punës, Sokolin, rëndom kafenë e mëngjesit e pimë bashkë. Dhe, bisedat që bëjmë janë nga më të ndryshmet. Por, këtë herë, më bëri përshtypje një konstatim i tij. E, cili është ai?

"Çudi me këto femrat tona!", më thotë ai dhe vazhdon: "Njëra më tha: Më vjen shumë keq për gruan tënde që fle me të në shtrat!".

E shikova në heshtje disa sekonda dhe i thash:

"Pse të të vij keq për gruan time? Ç'të keq të ka bërë?!".

"Jo, nuk ka të keqe, por unë të dua ty e ajo nuk e di a është e vetëdijshme për këtë gjë a jo!".

"Mirë, ti më do mua. Por, a më ke pyetur ndonjëherë se a të dua unë ty?!", ia ktheva.

"Jo, nuk të kam pyetur, sepse e di se ti i do femrat. E, pse të mos më duash edhe mua?!", ma ktheu.

Selim Rama

Si u bë kovaçi mësit?

Xhevit Hyko, 80 vjeç, ka punuar gjithë jetën e tij si kovaç dhe mullixhi, por “profesioni” që e bëri të famshëm është ai i mësitit.

“E kam nisur me një histori që u prish, por me kalimin e kohës më hyri në gjak kjo punë. Më përpara ishte ndryshe - shikonin fisin e rrethin e miqësisë, por tani është bërë më e vështirë, vajzat tani ruajnë veturën jo shoferin”, thotë ai. Xheviti tregon, gjithashtu, se si vepron për të realizuar një bashkim... “Kur dua të nis punën për bashkimin e një çifti, në fillim i drejtohem prindit. Kur e kam ndonjë rast vajze, zgjedh djalin në bazë të karakterit, të jetë njeri i mirë, njeri i punës, të jetë i lidhur me familjen, shikoj fisin. Ka raste kur janë çik të shkalafitur, i gjej shokun e saj, se nuk shkon një i mirë të marrë një të keq, po unë i gjej afërsisht shokun secilit që të shkojnë mirë. Kur martoj ndonjë femër që është ndarë, ndjej gëzim të dyfishtë, sepse vajza te prindi nuk ka rehati, vëllai ka familjen e tij, kunata se ka gjë, ndaj sa më parë të martohet aq më mirë është”.



Xhevit Hyko

Ç'THONË ÇIFTET QË MËSIT KANË PASUR XHEVITIN?

Alfrosit dhe Marsidës mësit Xhevit ua bëri ëndrrën realitet.

Alfrosi: “Njihesha me vajzën, e kisha parë në shkollë, por mentaliteti i vendit, prindërit e saj nuk donin që vajza të vinte në fshat ku banoja unë.

Kur Marsida u tregoi që më donte mua, ata e bënë të pamundur të takoheshim. Donin ta martonin vajzën në qytet. Kur më refuzuan, normalisht, nuk u ndjeva mirë dhe pyesja veten pse nuk më duan mua... Ju drejtova Xhevitit. Më tha se do të shkonte në familjen e vajzës dhe martesë do të bëhet herët a vonë...

Sot jemi të martuar dhe prindër të dy fëmijëve”.

Me kalimin e viteve situata ka ndryshuar dhe për Xhevitin puna e mësitit është bërë shumë e vështirë... “Tash lidhen që në shkollë, lidhen me telefona, nuk u trego-

jnë prindërve. Licenca ime tani ka rënë shumë”, thotë Xheviti.

Ç'THOTË SOCIOLOGIA ENTELA BINJAKU PËR MARTESAT?

Mënyra se si një çift njihet nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë.

“Momenti i fillimit kthehet, thjesht, në një histori që ua tregojnë pasardhësve. Ka plot raste kur fillimi mund të jetë i mbarë, qoftë lidhja me mësit qoftë me njohjen reciproke, por cilësia e jetës martesore varet më shumë nga elementë të tjerë dhe jo nga mënyra si janë njohur.

Një nga gjërat e mira që shoh në të shkuarën është besimi që shoqëria shqiptare kishte te martesë. Tani numri i martesave ka rënë, sepse njerëzit besojnë më pak në to, e mosbesimi ka ardhur si pasojë e historive të shumta të martesave të palumtura”, thotë sociologia.



**Laser-
Haarentfernung**



HAARE SCHNEIDEN

Damen
Kinder
Waschen & Föhnen

PREIS

30.00

20.00

20.00



Leonita Beauty Swiss 5014 Gretzenbach

- stoppelfrei
- schmerzlos
- seidenglatt
- mehr Lebensqualität & Wohlbefinden



GEHN DIE MEHR
SELBSTBEWUSSTSEIN MIT EINER
LASERHAARENTFERNUNG



VON KOPF BIS FUSS



Ç'kanë të përbashkët vera dalmatine dhe rasoji i shqiptarëve?

Hipa në tren për në Zagreb që të shkoja në Dalmaci të Kroacisë, por gjatë rrugës më zuri belaja...

Në kopenë e trenit ku ndodhesha, ndodheshin edhe një burrë e një grua, të cilët nën këmbë mbanin një klysh të vogël, e që herë-herë lehte. Burri nxori nga çanta shishen me verë dalmatine dhe ma ofroi një gotë. "Jo, faleminderit!", i thash dhe vazhdoja: "Unë nuk pi verë të butë! Ilirët e kanë bërë e pirë verën të fortë, por ju nuk jeni me rrënjë ilire. Rrënjë e tyre jam unë!".

Dhe, pa një e pa dy, nga çanta nxora shishen me rasoj, si gjak lepur i kuq. Ia hoqa kapakun shishes dhe e piva gjysmën e shishes përnjëherë. Ata më shikuan me habi dhe mbetën gojëhapur. Pritnin kur do më turbullohej mendja... Pas pak, nxora llullën me duhan tarabosh të Shqipërisë. I nxora nga goja dy shtëllungë tymi në kupe dhe këlyshin nisi ta merrte kolla. Gruaja më tha: "Fike llullën, se minoku do pëlçet nga tymi!". "Unë nuk e fiku llullën pa u harxhuar duhani", ia ktheva dhe shtova: "Jam me rrënjë ilire, zonjë!". Në çast, gruaja ma rrëmbeu llullën nga goja dhe e hodhi jashtë, meqë dritarja ishte e hapur.

Heu bela... Në çast m'u ngrit tensioni. Ia nxora nga duart minokun dhe ia hodha për dritare.

Zonja u tërbua. Në ato çaste burri doli në korridor dhe pas pak u kthye me konduktorin. Dhe, kur ai mësoi se ua kisha hedhur klyshin për dritare, nuk vonoi shumë dhe erdhi në kupe me dy policë. Ata më morën në pyetje dhe në stacionin e parë më zbritën nga treni.

"E tash, kah t'ia mbaj?!", folta vetë me veti. "Ku më zuri belaja me atë klysh!", folta me zë.

Dhe, dashje e pa dashje mendja më shkoi të xha Bajrami. Ai sa herë që nuk gjente zgjidhje për ndonjë problem thoshte "Zoti e bëftë llugël".

S. Murturi

BOOM

Perandoria e estetikës
“VIP Nails & Beauty”
e Lendita Frrokit
tani edhe në Gjakovë

Shprehja “Dashuria
nuk ka moshë”
jetësohet nga
të famshmet tona

Cilët janë
10 shqiptarët
më të pashëm?

“Dashuria nuk ka moshë” *jetësohet nga të famshmet tona*

SI U DASHURUA JONIDA MALIQI NË AKTORIN E RI VESHAJ?

Këngëtarja shqiptare, Jonida Maliqi, e aktori Romeo Veshaj, u bënë një prej çifteve më të komentuar në mediet rozë.

Derisa ishin në lidhje, Jonida ishte 37 vjeçe, ndërsa Romeo 24 vjeç. Lidhja e tyre ka përfunduar, ndonëse nuk bëhet e ditur se cila ishte arsyeja që ata u ndanë. Me gjasë, diferenca e madhe në moshë dhe kundërthëniet...



ARBANA OSMANI BURRIN MË TË RI DISA VJET

Moderatorja shqiptare, Arbana Osmani, është në lidhje dhe regjisorin e emisionit “Dua të të bëjë të lumtur” dhe tashmë të “Big Brother VIP”, Eduar Grishaj, me të cilin bashkëjeton dhe ka një djalë. Eduari është 34 vjeç, ndërkaq Arbana 38.

Katër vjet është diferenca në mes të çiftit, por kjo nuk duket se ndjehet. Ata përherë shfaqen të lumtur pranë njëri-tjetrit në postime që bëjnë në rrjete sociale, ku Arbana është mjaft aktive dhe sjell edhe pjesë nga përditshmëria e saj.



DUA LIPA E KA TË DASHURIN KATËR VJET MË TË RI

Këngëtarja me famë botërore, Dua Lipa, është në lidhje më vëllanë e motrave Gigi dhe Bella Hadid, Anvar.

Dua dhe Anvari kanë katër vjet diferencë në moshë. Por, pa-varësisht kësaj, çifti janë tejet të lumtur, madje kjo është lidhja më e gjatë e këngëtares Dua Lipa.

Pra, mosha nuk luan rol...



A E DINI SE TEUTA KRASNIQI ËSHTË MË E VJETËR SE ADONISI?

Aktorja kosovare, Teuta Krasniqi, është e martuar me trajnerin Adonis Morina.

Çifti bashkëjetojnë prej vitesh dhe kanë një vajzë. Historia e tyre e dashurisë është e njohur për publikun, e rrëfyer disa herë nga vetë aktorja e famshme, si një dashuri e fortë, pasionante dhe e singertë.

Teuta është disa vjet më e vjetër se Adonisi, por kjo gjë nuk e ka penguar çiftin të ndërtojë një marrëdhënie që meriton notën 10.



ADRIANA MATOSHI UA KALON TË GJITHAVE

Adriana Matoshi dhe futbollisti afrikan Keith Groendevl, janë çifti më i përfolur prej kohësh për historinë e tyre të dashurisë, diferencën në moshë dhe shumë detaje të tjera.

Ata kanë rreth 20 vjet diferencë, por kjo nuk i ka penguar ta jetojnë marrëdhënien e tyre. Adriana gjatë gjithë kohës është shprehur e lumtur dhe e plotësuar nga marrëdhënia me Keithin.

N.



Perandoria e estetikës “VIP Nails & Beauty” e Lendita Frrokit tani edhe në Gjakovë

Ka përvojë të gjatë në fushën e bukurisë dhe estetikës, ku ia ka dalë gjithmonë suksesshëm të ecë pa u ndalur. Janë rreth 20 vite karrierë, punë e pandalshme dhe profesionalizëm i klasit të parë.

Kjo është Lendita Frroki, e njohur si pronarja e “VIP Nails & Beauty”, që gjendet në Aragua të Zvicrës dhe atje ka një klientelë tejet të gjerë.

Lendita tashmë ka bërë hapa, duke e zgjeruar edhe më tej biznesin e saj, madje qendrën e re e ka hapur në Gjakovë.

“VIP Nails & Beauty” në Gjakovë do të jetë një opsion i ri për femrat që të marrin shërbime me një cilësi evropiane dhe nga një staf i trajnuar profesionalisht në fushën e estetikës.

Në “VIP Nails & Beauty” në Gjakovë do të ofrohen këto shërbime:

- * Depilim me laser
- * Manikyr dhe pedikyr
- * Tretmanë të ndryshëm kozmetike
- * Depilim me dyll
- * Mikrogjilpërim

Lendita thotë se të gjitha shërbimet do të ofrohen me profesionalizëm e përkushtim, delikatesë dhe korrektësi nga stafi i saj.

“Punën e bëj me shumë përkushtim, korrektësi, pasion e dashuri, sepse pa qenë të gjitha këto bashkë, vështirë mund të arrihet suksesi.

Kështu do të punohet edhe në qendrën në Gjakovë”, thotë pronarja.

**HAPJA
SOLEMNE**
31.10.2021
ORA 09:00 - 15:00



**VIP Nails &
Beauty**



Depilim me Lazer Pedikyr - Manikyr Tretman Kozmetik
Depilim me Dyll Mikrogjilpërim

LOKACIONI
Rr. Tirana - Gjakovë

KONTAKT
049 442 900

f @/vipnailsbeauty_ks

***Cilët janë 10 shqiptarët
më të pashëm?***

Media ndërkombëtare “Conan Daily”, ka publikuar, së fundi, një artikull ku renditen 10 meshkujt më të pashëm shqiptarë për këtë vit.

Pjesa më e madhe e 10-shes me shqiptarët më të bukur nuk jetojnë në Shqipëri.

Pjesë e listës janë aktorët Oni Pustina, Enver Gjokaj, Nik Xhelilaj, Niko Pepaj, këngëtari Alban Skenderaj, modeli Patrick Rukai, boksieri Valdrin Muriqi, futbollisti Jurgen Gjasula dhe ish-futbollisti Lorik Cana.

Ndërkaq, 10-shën e plotëson ish-konkurenti në “Përputhen” Mevlan Shaba.

Më poshtë renditja e plotë me 10 shqiptarët më të pashëm të vitit 2021...




Lorik Cana



Oni Pustina



Alban Skenderaj



Nik Xhelilaj



Mevlan Shaba



Enver Gjokaj



Patrik Rukaj



Jurgen Gjasula



Valdrin Muriqi

“Asnjë qeveri nuk na e dha bile një t’shtyme!”

Kosova ka vetëm një pesënjakë, të lindur në vitin 1996. Tre djem dhe dy vajza. Ata tashmë janë rritur, sepse edhe i kanë bërë bukur do vjet...



Pesënjakët në kohën e fëmijërisë

Ata u rritën dhe buzëqeshën larg syrit institucional kosovar dhe medieve, të cilët janë në gjendje t’u kushtojnë shkrim ballinave mediale për incidentet e këngëtareve komerciale, por jo edhe pesënjakëve që u rritën në një dhomë të vetme banimi.

Pesë buzëqeshje të njoma, të lindur brenda pesë minutash, janë të vetmit në Kosovë që pakkush mund t’u besojë se janë pesënjakë. Tre djelmusha dhe dy vajza, secili më i bukur se tjetri, lozën në një banesë 60 metër katrore në Prishtinë.

U lindën më 26 janar të vitit 1996 në Beograd. Babai, Mehdi Bekteshi (1968) dhe nëna, Shehinazja (1969), janë bashkëshortët e vetëm në Kosovë, të

cilët për një ditë janë bërë të lumtur me pesë trashëgimtarë.

Në vitin 2006, kur edhe vizitua Mehdiun dhe bashkëshorten e tij, dukeshin të lumtur në mesin e të pestëve, të cilët nxitonin t’i përqafojnë, pa ndonjë rend.

Xheneta, Kushtrimi, Arjeta, Kreshniku dhe Kastrioti, janë pesënjakët që mund të bëjnë një ekip futbollit të vogël. Kurioziteti kosovar që është krejtësisht unik në Kosovë, megjithatë, nuk është përshkruar me publicitetin e duhur medial, që do të shërbente për humanitetin njerëzor, për t’ia lehtësuar Mehdiut investimet në rritjen e pesë fëmijëve që erdhën në jetë për një çast.

“Mediet tona, gazetarët dhe institucionet publikuan me muaj të tërë incidentin e njohur mes këngëtareve që nuk po ua përmendi emrat dhe t’i prezantojnë në ballinat e medieve, duke u dhënë aq shumë rëndësi, ndërsa mua, apo ndonjë rast si imi, as që u intereson, të paktën, për të pyetur a kanë fëmijët libra, bukë, veshmbathje dhe gjërat më elementare, përfshirë edhe kulmin mbi kokë, të cilin na e dogji lufta shkrumb e hi, në Dumnicë të Vushtrrisë.

Njeriu nuk e di kujt t’i besojë dhe nuk di a ndihet njeri i trajtuar ligjësisht nga institucioni dhe shteti, kur është në ditë të vështira, sikur unë që i mbaj pesënjakët e mi, me punën shitës në tregun e “Ulpianës”, thotë ai.

E DINIM PËR KATËR, I PESTI NA BEFASOI!

Duke i shpjeguar rezultatet e kontrollimeve në kohën e shtatzënisë së gruas, Mehdiu thotë se fillimisht e ka informuar dr. Zylfi Azizi se bashkëshortja e tij ka binjakë.

“Ishalla tre!”, i thash.

“Qe besa, tre i ke!”, ma ktheu doktori.

“Ishalla katër janë!”, ia ktheva.

“Hiç mos u lut se katër i ka gruaja jote, por nuk desha të ta them”, më tha ai.

“Ishalla pesë doktor!”

“Boll, mos e zgjat më shumë!”, ma mbylli gojën doktori.

E shoqja e tij, Shehinazja, thotë se nuk ka pasur asnjë komplikim me shtatzëninë.

Mehdiu ka zhvilluar shumë konsultime me mjekë rreth problemit të lindjes së bashkëshortes dhe koha në

të cilën ndodhej Kosova nuk i ka lejuar atij komoditet që procesi i lindjes të kryhet në Kosovë.

Mungesa e mjekëve shqiptarë në klinika dhe gjendja e krijuar në vitin 1989 në Kosovë, ishin dy probleme, të cilat Mehdiun e kishin shtyrë të organizohej për lindje jashtë Kosovës.

“Ta dërgoja shoqen në Maqedoni, ekzistonte nacionalizëm tepër i theksuar atje.

Në Shqipëri, gjithashtu, kishte filluar një lëvizje pasigurie rreth projekteve piramidale dhe vinte era luftë qytetare.

As në Turqi nuk kisha motiv të shkonim, sepse kishte shumëçka që na pengonte, gjuha së pari.

Disa mjekë tanë, me përvojë, më thanë ta dërgoja gruan në Beograd. U konsultova edhe me Dr. Selim Krasniqin dhe vendosa ta dërgoja gruan në Beograd”.

RRUGA MË E VËSHTIRË E JETËS SIME - SHKUARJA NË BEOGRAD

Mehdiu, gati dhjetë vjet më vonë, mban mend se atë ditë kur ishte nisur për në Beograd me bashkëshorten, ishte dita më e vështirë e jetës së tij.

“Ka qenë mot shumë i keq, akull e borë. Erdhi momenti me u nis për në Beograd. I bëmë nëntë orë rrugë dhe hymë në qendrën spitalore gjinekologjike në Beograd.

Pas 15 minutash të vendosjes në klinikë, u lind Xheneta. Një minutë pas u lind Kushtrimi, e një minutë më vonë u lind Arjeta. Pas një minute Kreshniku dhe në minutën e pestë Kastrioti.

Të gjithë u lindën brenda pesë minutave. Lindja ishte me prerje cezariene, pesha e pesënjakëve në total ishte 7.5 kilogramë.

Pas daljes në dritë, secili prej fëmijëve, me vendimin e personelit mjekësor, është dërguar në inkubator, ku kanë qëndruar dy javë e ndonjëri edhe një muaj.

Mjekët nuk kanë kërkuar ryshfet. Të lindësh pesënjakë, për mentalitetin e mjekëve të atjeshëm, ishte përparësi e madhe dhe privilegj i veçantë”, thotë ai dhe shton:

“Fëmijëve ua kam lënë emrat derisa ndodheshin në spital. Pas tetë ditësh e



Pesënjakët në kohën e studimeve

kanë lëshuar nga spitali bashkëshorten, kurse fëmijët kanë mbetur në inkubatorë”.

PESËNJAKËT TË SHKËLQYESHËM NË SHKOLLË

Tre djelmoshat e veshur me të njëjtën ngjyrë dhe dy vajzat e veshura me rroba të njëjta, bashkëpunojnë ngushtë për detyrat e shkollës.

Janë nxënës të shkëlqyeshëm, të klasës së katërt në Shkollën Filllore “Dardania” në Prishtinë.

E ngacmojnë babanë herë pas herë. Dinë të krijojnë atmosferë dhe me një unitet e harmoni të veçantë, përbëjnë fuqinë e tyre në banesë.

Por, si dhjetëvjeçarë, pesënjakët kanë edhe momentet e tyre të hidhura, si pjesë e familjes. Kohën e luftës e kaluan në malet e Dumnicës së Llapit, duke qenë pa gjërat më elementare të jetës.

E, pas lufte nuk kishin ku të kthehen, sepse serbët dogjën çdo gjë që u përkiste. Erdhën në qytet, në banesën që nuk kishte dyer e dritare. E kaluan kohën e fëmijërisë pa gjërat më të nevojshme që u duheshin.

Edhe sot, babai i tyre, me shumë mundime, siguron ekzistencën dhe shkollimin e tyre si punëtor i përditshëm në tregun “Ulpiana” në Prishtinë.

Aq më shumë kur fëmijët e kuptojnë se askush nuk i ka ndihmuar, si para lufte si pas lufte...

“Kam dëgjuar me veshët e mi, duke thënë se i kanë ndihmuar fëmijët e mi. Them publikisht se krejt çka kam marrë për 5 fëmijët, janë 2700 euro në vitin 2006. Asgjë më shumë. Këto mjete kanë ardhur nga Gjermania, Zvicra dhe Bujanoci. Firma e vetme kosovare që më ka ndihmuar është “Ciciban”.

Në një vend tjetër, një çift bashkëshortor si rasti im, do të fitonte banesë, veturë dhe benificione të tjera, ndërsa që ne, në Kosovë, as që brengoset kush për këtë punë...”, thotë Mehdiu.

SA PESËNJAKË JANË NË BALLKAN?

Sipas të dhënave, janë katër raste të pesënjakëve në Ballkan.

“Unë jam ndër të parët. Dy raste janë pas meje, nga Shqipëria. Një rast tjetër në Çaçak të Serbisë.

Sikur të kisha kushte më të mira, do të filloja me lindje të reja. Nuk do të kishte lidhje sa fëmijë vijnë në jetë. E tash, si jam materialisht, nuk mund të marr hap të tillë. Sepse, së pari, s’kam banim të duhur, e pastaj s’kam as kushte”, thotë ai.

Safet Krivaça

Jeta e miseve...



Dikur në jetimore të Serbisë, tash mis i Kosovës

“Familja ime, në bashkëpunim me policinë, kanë ardhur në Serbi, në jetimore dhe më gjetën”.

“Miss Universe Kosova”, Shkurtesa Sejdiu, ka bërë një rrëfim të rrallë për jetën e saj familjare dhe private. Tuti, pseudonimi që prindërit i vunë kur ishte e vogël, për shkak se ishte frikacake, zbuloi se në moshën 13-vjeçare është përdhunuar dhe trafikuar nga disa persona nga Kosova në Serbi. “Arsyeja që kam ardhur në “Miss Universe” janë familja ime. Kam aplikuar, kam ardhur dhe nuk e kam besuar që jam fituesja. Kjo kurorë i dedikohet vetëm familjes time që kanë sakrifikuar shumë për mu, e vazhdojnë të sakrifikojnë”, tha ajo. Tuti tha se në moshën 13-vjeçare është rrëmbyer, përdhunuar dhe trafi-

kuar nga disa persona. Interpoli e gjeti në Serbi dhe kontaktoi familjen e saj për t’i thënë se ishte gjallë dhe mirë. “Në moshën 13-vjeçare jam përdhunuar e jam trafiku nga persona të ndryshëm nga Kosova në Serbi, derisa prindi jem nuk ka lënë institucion pa kërkuar drejtësi. Ata njerëz që janë munduar me ma marrë mua jetën, sot janë në liri, nuk janë në burg. Interpoli më ka gjet në Serbi, jo në Kosovë. Ata kanë pasur obligim me më gjet mu e me më kthye te familja. Familja ka ardhur e më ka marrë. Nuk kam pas dijeni, kam qenë në jetimore, se Interpoli nuk ka mujt me më kthye direkt në Kosovë, se marrëveshja mes

Kosovës dhe Serbisë nuk ka qenë e lehtë me u bo. Familja ime, në bashkëpunim me Policinë, kanë ardhur në Serbi, në jetimore dhe më gjetën. Ka qenë shumë e vështirë, por momenti më i lumtur i jetës sime ka qenë në orën 7 të mëngjesit vjen një fëmijë aty dhe më thotë serbisht “kanë ardhur mami, babi...”. Nuk e kuptova mirë çfarë më tha. Kur kam zbritur poshtë, kam pa mamin dhe babin që nisën të qanin shumë dhe nuk e besonin që unë jam gjallë. Se ata s’e dinin nëse jam gjallë, derisa Interpoli u ka dhënë lajm familje sime se unë jam mirë dhe jam në duar të sigurta”, tregon Shkurtesa.



KOMPLEKSI POJATA SUHAREKË



rr. Rrust Kabashi
Lagjia: Dardania

A black and white photograph showing the silhouettes of a man and a woman. The man is on the left, leaning forward with his arm extended towards the woman. The woman is on the right, looking away from him with her hand near her face, suggesting a moment of conflict or emotional distress.

Nuk ka ditë të mira për mua...

Pse nuk po mund të rehatohem me martesë?

Jam 48 vjeç, nga Prizreni. Me gruan jam ndarë vitin që shkoi. Thënë të drejtën, u përpoqëm shumë që ta kuptojmë njëri-tjetrin, por nuk hasëm në mirëkuptim dhe thamë: Më mirë të ndahemi se tërë jetën të përllahemi!

Një mbrëmje, pas një përllarje të madhe, sa gati edhe u grushtuam, morëm vendim të ndahemi, secili rrugës së vet. Ajo, të nesërmen, mblodhi gjërat e saj

dhe shkoi në familjen e vet. Ndërkaq unë, përkundër vuajtjeve nga dashuria, nisa jetën e re...

U lidha me një femër nga Shqipëria, nga Kukësi, ku edhe shkoja shpesh dhe me të cilën kaloja mirë. Dhe, pas një kohe bashkë, mendoja të martohesha me të. Por, mu ato ditë mora një sms nga ish-gruaja, të cilin as që e prisja.

U tmerrova kur ish-gruaja më tha se unë jam babai i fëmijës së saj. Dhe, me anë të një testi ADN-je mësova se isha i babai i foshnjës. Tani kam frikë se do ta humbas gruan nga Kukësi, e që e dua shumë dhe kam shumë mirëkuptim me të.

Dhe, që të mos e humbja, vendosa t'i tregoj realisht se si kishte vajtur puna. Por, ajo në fillim reagoi keq e më vonë

sikur u qetësua pak dhe ma bëri me dije se më kuptonte, meqë fëmija qenka nisur në kohën kur ende jetoja me ish-gruan time.

Ajo është bukur më e re se unë, 34 vjeç. Por, po frikohem se herë do kur do më tradhtoj ose do largohet nga unë...

Por, problemi edhe më i madh është se ish-gruaja nuk dëshiron ta rrisë fëmijën tim, por do më detyroj ta marrë unë.

E, kukësjania, me siguri, nuk do të pranojë të martohet me mua...

Andaj, jam në hall të madh: kam dëshirë ta marrë fëmijën tim e ta rritë, por frikësohem se do të mbetëm pa të dashurën, me siguri, e që e dua shumë...

D. Y.



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Dikur vajzat martoheshin të reja, nuk i prisnin të 20-at, ndërkaq sot ka ndryshuar puna. Sidomos kjo gjë shihet te këngëtares tona. Se në estradë ka shumë këngëtare beqare, kjo është e dukshme.

Nuk duan të martohen apo nuk gjejnë të dashur?

ME KË ËSHTË NË LIDHJE ELVANA GJATA?

Elvana Gjata i ka mbushur 34 vjet, por as që e diskuton punën e martesës. Elvana viteve të fundit nuk flet fare për ndonjë lidhje konkrete. Adhuresit e kanë lidhur e “fejuar” disa herë.

Është folur e përfolur se është në marrëdhënie me këngëtarin Flori Mumajesi, ndonëse këtë gjë asnjëra palë nuk e ka pranuar asnjëherë.



MIMOZA SHKODRA ENDE “SINGLE”

Bukuroshja, Mimoza Shkodra, jetën e saj private e ruan me fanatizëm të rreptë. Qëkur u nda nga këngëtari Seldi Qaliu, ajo nuk është përfolur për ndonjë lidhje të re.

Pse? Ka mësuar nga pësimi i martesës së parë apo nuk e ka gjetur dashurinë e re?

Në këtë kategori, ka edhe shumë të tjera, pa dyshim, por nuk po i zëmë në gojë...



remos®



Aachener Straße 21 | Köln
Ulmenstraße 30 | Frankfurt
Westerwaldpark 4 | WW
Bahnhofplatz 5 | Koblenz
remos-restaurants.de




[remos_restaurants](https://www.instagram.com/remos_restaurants)



Në cilën moshë arrihet lumturia?

Qëllimi më i lartë në jetën tonë, me siguri, është lumturia. Megjithëse ka teori që thonë se lumturia nuk ekziston dhe se ka vetëm copëza lumturie, ka të tjerë që lumturinë e lidhin me një nocion të së shkuarës. Por, studiuesit kanë treguar se, megjithatë, ekziston një periudhë në të cilën njeriu arrin kulmin e lumturisë...

Ata tregojnë se mosha që do të ndihemi më tepër të lumtur do të jetë ajo 33-vjeçare. Burimi i kësaj lumturie do të jetë, sipas psikologëve, gëzimi familjar dhe ndjenjat që do të ekzistojnë ndërmjet partnerëve, pa harruar të përmendim edhe ar-

dhjen në jetë të fëmijëve, ecurinë e mirë në karrierë që në këtë moshë, zakonisht, është arritur, si edhe optimizmin që e karakterizon njeriun si pasojë e pjekurisë dhe pavarësisë që ka arritur. Psikologët shpjegojnë se në moshën

33-vjeçare njeriu ka eliminuar nga vetja naivitetin e fëmijërisë dhe rebelizmin e adoleshencës, duke pasur brenda vetes tashmë një ndjenjë të fortë shprese dhe bindjeje për talentet apo aftësitë që zotëron.



Njerëz të zakonshëm apo të famshëm, nën presionin e dilemave, vështirësive, e shpesh të famës e të qenit persona publikë, i ekspozojnë ata ndaj fenomeneve të papritura që bëhen shkas për luhatje të humorit, vetëbesimit, ankthit, dominim nga mendimet negative e mbytëse etj. Andaj, kush janë të famshmit tanë që e kanë pranuar vetë se kanë probleme me depresion?



FLAKA KRELANI

Këngëtarja e njohur kosovare është një nga artistet e njohura që në daljet e saj publike nuk ka ngurrar të pranojë hapur problemet që ka pasur me shëndet. "Fundi i vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019 ka qenë i vështirë për mua fizikisht dhe mendërisht. Arsyeja që po shprehem është se secili prej nesh ka vështirësi të cilat janë normale. Zhgënjimet, gjithashtu, janë normale. Mungesa e motivimit nuk është fundi i botës apo gjëra të tjera që na bëjnë të ndihemi keq. Do të doja të gjitha të ishin si ilaçe që të mund t'i konsumoja çdo ditë, sepse më ndihmojnë të arrij gjithçka që dua në jetë. Andaj, kthejeni veten në prioritet dhe mos e ktheni "problemin" në problem, sepse ai nuk ekziston. Shëndeti është e vetmja gjë e rëndësishme në jetë", ka thënë ajo.

Cilat këngëtare tona kanë probleme me depresion?

RITA ORA

Një tjetër divë e muzikës shqiptare, një yll i muzikës botërore, si Rita Ora, nuk e ka pasur fare problem që të shprehet në publik për problemet me ankthin. "Vuaj nga ankthi dhe kam frikë të pranoj që kam qenë në terapi. Edhe kohëve të fundit flas me një specialist një herë në javë", është shprehur artistja.



BEBE REXHA

Këngëtarja shqiptare është absolutisht një nga yjet e muzikës botërore. Nuk janë vetëm prurjet e saj artistike dhe bashkëpunimet muzikore ato që e bëjnë protagoniste të kopertinave më prestigjioze në botë. Pikërisht, në një prej tyre, "Teen Vogue", për herë të parë Bebe Rexha pranoi hapur problemet serioze me shëndetin mendor.

"Unë qaj shumë. E kam të vështirë. Kam terapistin tim dhe kam njerëz me të cilët flas. Është një betejë e përditshme, mendoj. Unë nuk dua ta ushqej, por jeta ime është kaq e çmendur. Kur shkova fillimisht në vitin e parë të kolegjit, isha kaq intensive. Unë nuk dija se si të reagoja dhe të përfshiheja mes njerëzve. Unë kam qenë shumë e shqetësuar gjatë gjithë kohës. Isha e shqetësuar kur isha vajzë e vogël, thjesht nuk e dija se çfarë ishte. Së fundi, e kuptova se kam ankth", ka thënë ajo.

Ndër të tjerash, ajo ka rrëfyer se si i ka ardhur frymëzimi për hitin global "Monster". "U mbylla në shtëpi tre muaj. Nuk pranoja të largohesha. Babai vinte në dhomën time të gjumit, më kapte dorën dhe më thoshte: "Le të dalim pak", duke më marr me zor të shkoja në shëtitje me të. Më kujtohet rruga që bënim. Unë i jam mirënjohëse babait për shumë gjëra, por e vetmja gjë për të cilën jam gjithmonë falënderuese për të është se në atë kohë, kur isha në errësirën time dhe motivimin më të ulët, ai, thjesht, më kapte dorën dhe më ftonte të dilim bashkë. Ne ndalojmë së kërkuari përbindëshat që janë nën shtrat kur kuptojmë se janë brenda nesh. Nga ky edhe lindi frymëzimi për krijimin e hitit global "The Monster", thotë ajo.





DAFINA ZEQRIRI

Artistja e adhuruar, me shumë këngë të kthyer në hite, ka bërë për vete miliona fansa në Kosovë, Shqipëri e gjetkë.

Dafina Zeqiri nuk njihet vetëm për ndryshimet e guximshme në stilin e veshjeve, sidomos në modelin e flokëve, por edhe për mënyrën e hapur si i flet gjërat.

E drejtpërdrejtë, Dafi nuk ka hezitur të flasë edhe për një nga periudhat më të errëta në jetën e saj. Problemet me depresionin, arsyet dhe sugjerimet e saj të vlefshme.

“Depresioni është real dhe mund të jetë i dukshëm. Flisni! Kujdesuni për njëritjetrin! Mos e merrni mirësinë për dobësi! Mos e merrni dashurinë, besnikërinë dhe suportin të garantuar!”, thotë ajo.

LORI HOXHA

Trashëgimtarja e pasur e “Top Channel”, njëherësh një nga vajzat më frymëzuese për brezin e ri për stilin e veshjes, për jetën dhe përditshmërinë që ajo shpesh e ndanë me publikun virtual përmes postimesh të ndryshme, ka bërë të besojmë se gjithçka në jetën e saj është në kufijtë e perfeksionit.

E përmbushur në çdo aspekt të jetës, e lumtur, por ja që në thelb problemet paskan qenë aty. Vetë Lori ka pranuar se në një periudhë të jetës ka vuajtur nga ankthi dhe paniku.

“Në këtë periudhë mezi postoja, sepse vuaja nga ankthi dhe paniku. Faleminderit Zot për ndryshimin!”, ka thënë Lori.



FIFI

Këngëtarja e njohur, Fifi, në “Big Brother VIP” publikisht tregoi për luftën që ka fituar me ankthin dhe depresionin.

“Trupi im nuk i përballon dot emocionet e forta, sidomos stresin dhe frikën. Më bien të fikët menjëherë. Episodi i parë ka ndodhur në vitin 2015, kur isha pjesëmarrëse në një festival. Dhe, që atëherë, vazhdoi disa herë rresht. Ishte shumë e vështirë, të gjithë më thoshin që unë nuk do t’ia dilja dot në muzikë”, thotë Fifi.

Fifi sqaroi se mjekimi lidhur me këtë problem ishte shumë i vështirë, madje i shoqëruar me komplikacione të shumta.

“Nisa të përdorja ilaçe, por më dhanë shumë efekte anësore. Nisa të shihja halucinacione dhe të dëmtoja dhe veten prej tyre. Lëndoja veten me çfarë gjeja në shtëpi”, shtoi ajo.

Këngëtarja tregoi se vendosi të punonte shumë me veten dhe se shërimin e ka gjetur tek besimi në Zot.

Vitet e arta...



Si ishte Bleona Qereti ndër vite?


Këngëtarja e njohur, Bleona Qereti, është emër i padiskutueshëm i muzikë sonë shqipe. Ajo e ka filluar karrierën si këngëtare shumë herët dhe tashmë është bërë e njohur, madje edhe në Amerikë.



Gati po bëhen 27 vjet qëkur Bleona, 14 vjeçe, fitoi konkursin për të marrë pjesë në festivalin e dhjetorit. Dhe, në kuadër të këtij përvjetori, këngëtarja radhitë këngët e saj më të bukura dhe është shprehur se 25 Nëntorin e vitit 1994 nuk do e harrojë kurrë. "25 nëntor 1994 është data që fitova konkursin për të marrë pjesë në festivalin e dhjetorit. Është një datë e cila do të ngelet përgjithmonë në memorien time. Kanë kaluar vite e vite nga ajo kohë, por unë nuk e harroj atë ditë me shi që prisja para televizionit për të marrë rezultatin e konkursit. Babai im mendohej t'më fuste nën



çadër, që të mos lagesha. Por, nga ankthi dhe emocionet nuk ndjeja asnjë pikë shiu që më binte në fytyrë, derisa i ndjeri Selim Ishmaku doli nga televizioni dhe na tha: "Ne, si juri, mendojmë se Bleona duhet të këndojë në festival". Dhe, nuk arrita të ndalja lotët...". E, tash, ku ndodhet Bleona Qereti? S'ka dyshim, në piedestalin më të lartë muzikor.





PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulltet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Rrjedhën e Valbonës e ndali për ty!

Atë mbrëmje të bukur ecja bregut të lumit nëpër ëndrrën time, për të arritur te ti rrugës zik-zake, jo aq të lehtë e jo të pamundimshme. Të kërkova nëpër terrin e natës gjithkrah, brigjeve të lumit e labirinteve pranë tij, madje edhe nëpër pallatet me shigjeta...

Të gjeta atje ku më prisje, në lartësi të Llogarasë, në afërsi të qiellit, ku engjëjt kishin fronin e tyre. Atje të gjeta ashtu siç ishe gjithmonë: e bukur, engjëjllore dhe e qetë. Ishe më e qetë se vetë deti Jon, kur është i patrazuar. Ishe më madhështore e më e bukur se maja e Lybetenit, e shtathollë si lumi i Valbonës. Ishe më e bukur se Deti i Himarës me guralecët e bardhë. Pra, e bardhë ashtu siç është vetë zemra jote...

Por, shëmtia e territ m'i mori edhe ato pak ëndrra që i kisha për ty. Dhe, ashtu i etur për dashurinë tënde, u mundova të humbja mes ëndrrave që do t'më qonin atje ku dëgjohet gjëma e detit në brigjet e Jonit të bukur, të cilit i ngjason. Sidoqoftë, nata e zymtë iku ngadalë, për t'i lëshuar vendin ditës së re, ditës së shpresës që ushqeja për ty. Por, edhe shpresat shteruan atëherë kur kuptova se ti ende kllapiteshe me dergjën e natës që kishte ikur.

Megjithatë, nuk më largoheshin nga koka sytë tu të bukur si ullinj Berati, ata sy ngjyrë kafeje që ka herë më kishin magjepsur. Nuk më largohej nga mendja as fytyra jote e bukur që më kishte robëruar... Nuk më largohej nga mendja as sharmi glamuroz dhe virtytet tua që më dhanë forcë të luftoj për ty, të luftoj - sepse të dua, për çka edhe rrjedhën e Valbonës do e ndalja për ty...

P.



Pse Bërnica është bërë fshati më i kërkuar i Prishtinës?

Bërnica aktualisht është fshat që e trazon e kaluara e krimeve, ku serbët vranë 7 shqiptarë, por që sot është shndërruar në periferinë më të kërkuar. Një ari truall shitet 10 mijë euro.

Bërnica, fshat me mbi 300 shtëpi, ngjitur me Prishtinën, është ndër të paktët e periferisë së kryeqytetit që po bëhet fshat i shtrenjtë. Kërkesat për të jetuar në të sa vijjnë e shtohen, kryesisht nga shoqëria e lartë elitare, shtresë që lidhet me politikanët ose muzikën.

Fshati në të cilin një ari truall shitet 10 mijë euro, po shndërrohet në periferinë më të kërkuar të Prishtinës, për një jetë të qetë dhe afër kryeqytetit.

Bërnica e Epërme është ajo që, kryesisht, ka dalë të jetë e kërkuar në tregun e shitblerjes, por këtu nuk është përjashtuar as Bërnica e Poshtme, që shtrihet poshtë asfaltit Prishtinë-Podujevë.

Megjithatë, nuk ishte çdo herë kështu në Bërnice. Gjërat ndryshuan pas luftës, më 1999. Në lagjen "Dragushaj", që është më e madhja në Bërnice dhe Epërme, Amir Dragusha shpalos historikun e fshatit dhe kjo tregon se në Bërnice ende më shumë flitet

për të kaluarën e dhimbshme serbe që ka ndodhur, sesa për të mirat e tanishme që sjell fryma e re e jetës.

Amir Dragusha, pronar i autoservisit "Dragusha", thotë se ndikimi serb ka qenë shumë i madh në këtë fshat. Ata ishin bosë që e diktonin jetën para vitit 1999. Duke folur për ngjarjet e paraluftës, ai thotë: "Gjatë luftës këtë fshat e përgjakën serbët dhe paramilitarët e këtushëm. E tash, po në këtë fshat të përgjakur, po blejnë troje e po ndërtojnë vila VIP-at që kanë emër si në politikë, në ekonomi, në muzikë... Me këtë dua të them se Bërnica po bëhet shumë e kërkuar dhe atraktive. Po ndërtohet me të madhe dhe është në trend të kërkimit edhe për shumë të tjerë.

Ky fshat ka një luginë që i përngjan Prevalës. Kur verës është nxehtë, në mbrëmje këtu bën freskët. Lugina ofron freski e ajër të pastër. Zona gjysmëmalore, që

lidhet me pjesën që qon në Gallap dhe me Milevcin, e bën ajrin shumë të freskët, prandaj në treg është rritur çmimi i tokës së fshatit.

Këtu është ndërtuar edhe një lagje e re si në Prishtinë.

Prandaj, ky vend po bëhet periferia më e kërkuar e Prishtinës, vend që u përgjak në luftën e vitit 1999, por që po shërohet falë ndërtimit të madh që po bëjnë njerëzit këtu.

Brenda fshatit funksionojnë disa restorante-motele shumë të mirë dhe kualitativ që kanë bërë emër, por edhe lokale të tjera. Por, natyra është baza kryesore që e bën Bërnice të kërkuar", thotë Amiri.

Sidoqoftë, Bërnica është fshat në të cilin insistonte ta ruante ndikimin veçmas politika komunale e LDK-së, por që tetë vjet kryetar komune është Shpend Ahmeti dhe gjërat kanë ndryshuar...

Safet Krivaça

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

një mënyrë tjetër që nuk ndërlihet me shenjat e kiametit.

Ma thuaj fatin e shtëpisë sime?

E nderuara dhe shumë e respektuara magjistare, jam lexuese e rregullt e "Kosovares", sidomos e rubrikës tuaj, të cilën e adhuroj shumë.

Dua t'më thuash për fatin e shtëpisë sime...

"Kureshtarja"

Përgjigje:

Besoj se do të ndodhë më e mira në familjen tuaj, ndërsa e mira e juaj më e madhe është ta keni shëndetin dhe ta bëni kulmin tuaj që tash nuk e keni.

Unë shoh ndryshime te ju dhe e di se do ta keni shtëpinë tuaj dhe kjo brengë do të eliminohet nga shpirti juaj.

Probleme me motër

Jam 47-vjeçar, i kam tre fëmijë. Kemi jetë mesatare. Jetojmë në Prishtinë. Jemi rritur pa prindër. E kam vetëm një motër. Motra e ka kryer fakultetin, por është mbuluar qe dy vjet. Ajo është e martuar dhe ka fëmijë. Unë nuk i përzihem askujt në bindjet e veta, por çka nuk më pëlqen është se motra ime nuk u fol përdore njerëzve...

I kam bërë vërejtje se sjellja e saj nuk është e mirë, por ajo kategorikisht mendohej ta mbronte konceptin e vet, duke shkuar aq larg sa tha se në dorë fshihet djalli e shejtani!

Nuk po mund ta shoh motrën me sjellje të tillë, edhe pse nuk jam kundërshtar i fesë islame, por nuk jam as për të shkuar aq larg me sjellje të tillë, sepse neve na njohin rrethi ynë dhe nuk dua të shtiremi "më katolik se papa"!

A na kanoset kiameti sivjet?

Përshëndetje zonja magjistare! Jam grua, 58-vjeçare, jetoj në Prishtinë. Dëgjoj se çdo ditë ndodh diçka e pabesueshme: dridhje toke, tajfun, kometa të ndryshme që do e godasin tokën etj. A jemi në rrezik të zhdukemi si qenie?

"Nëna e shqetësuar"

Përgjigje:

Unë shoh se nuk do të ndodhë asgjë e veçantë. Por, se është një planet në një vijë harkore të diellit, që fare pak qëndron në zonën e gravitetit të tij, kjo është e vërtetë. Këtë e ka thënë NASA (Agjencia për Hulumtimet dhe Ndryshimet në Gjithësi). Sa ka gjasa që ky planet të shkëputet nga orbita, nuk e dimë, por as NASA nuk e ka konfirmuar e as mohuar, mirëpo ka deklaruar se një planet po qëndron jashtë orbitës së diellit dhe nuk është i parrezikshëm. Kiameti është fundi i botës, e këtu nuk ka dyshim fare. Në filozofinë shkencore dhe në të gjitha librat hyjnorë e fetarë ekziston konfirmimi se kiameti do të ndodhë, por kur nuk dihet. Nëse i referohemi këtij fakti, këtë e di vetëm Zoti i madhërishtëm.

E, cilat janë shenjat e kiametit?

Në Kuran ekzistojnë tre grupe shenjash të kiametit, dy prej të cilave i kemi kaluar plotësisht, ndërsa grupi i tretë, e që i ka dhjetë shenja, po e përjetojmë. Në këtë grup shenjash thuhet se do të qahet toka apo shafitet. E, kjo ka nisur të ndodhë në kontinentin e Afrikës, që në hulumtime po quhet "qarja e madhe", një proces i cili pritet ta ndajë në dysh Afrikën.

Nuk është më e mirë as gjendja ekliptike, sepse shpesh ka zënie të diellit, ndodhi errësimi i plotë gjatë ditës...

Njerëzit e Inuit, që ndryshe njihen me emrin "Fisi i akullnajave", e që jeton në varësi të kushteve klimatike në rajonet akull të Alaskës dhe Grenlandës, para një kohe paralajmëruan një tmerr, duke folur me fakte se toka po zhvendoset. Konstatimin e bazuan në faktin se dielli po lind në tjetër vend dhe se dita është zgjatur shumë. Njerëzit e Inuit kanë thënë se edhe hëna ka ndryshuar, por edhe yjet dhe qielli. Pra, ka paralajmërime që nuk janë të mira, por kësaj radhe nuk flasim për ndryshimet klimatike, si pasojë e ngrohjes globale, të cilat janë një mbarim i jetës në tokë, në

A kam të drejtë, motër e nderuar, sepse gruaja më bëri shumë kritika pse i thash motrës të jetë më e pranueshme për rrethin tonë?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Unë personalisht jam me konceptin e islamit tradicional dhe në mbrojtje të Kuranit dhe jo për bindje të kombinuara, sikur është duke ndodhur sot, kur njerëzit, përfshirë edhe botën femërore, marrin nga librat vetëm atë që u duhet atyre.

Shiheni se çka po ndodhë brenda botës islame në shtetet arabe, kur lufta e fundit është drejtuar kundër liderëve të të ashtuquajturit “shtet islamik”, ku anët e errëta të tij janë aq të mëdha në të gjitha sferat, e më së shumti në abuzimet morale!

Dhuna nuk është zgjidhje... Nuk kthehen me dhunë njerëzit në koncepte religjioze...

Dhe, t’i kthehemi pyetjes tënde...

Përhëndetjet me dorë nuk janë të ndaluara, ashtu si nuk është se të mbush moral dhe etikë as mbuloja. Nuk është se të bën më mysliman mjekra më e gjatë apo më e shkurtër, por sjellja.

Islami bazohet në pesë shtyllat qendrore që e mbajnë fenë, e nuk bazohet në mjekër apo mbulesë. Por, e drejta e femrës është sërish të zgjedhë vetë stilin e veshjes, por kjo duhet të ndodhë duke përjashtuar veshjen e stilit të rrezikshëm, sepse po shohim çka po ndodhë. Vrasja e fëmijëve, siç po ndodh shpesh nëpër botë, është në kundërshtim me çdo fe. Nuk di të ketë fe e cila thotë dil e vrajë fëmijë apo njerëz ta pafajshëm?

Prandaj, të mos ia zgjasësh dikujt dorën e ta mbash tërë ditën telefonin në dorë, është në kundërshtim

me vlerat njerëzore. Djalli fshihet çdo kund, por edhe përjashtohet çdo kund ku ka edukim dhe arsimim, si dhe besim e korrektësi. Konkretisht, keni pasur të drejtë që motrës i keni bërë vërejtje...

Emri i burrit që do ta kem...

Përhëndetje, jam kureshtarë të di se kë do ta kem burrë në të ardhmen?

A mund t’ma thuash emrin e burrit që do e kem në të ardhmen?

Do të gëzohem po t’më kthesh përgjigje...

“Sara”

Përgjigje:

Emri yt i vërtetë nuk është Sara, por burri yt që do ta kesh fat do jetë Amiri.

Jam e mallkuar që nuk e kam personin që e dua!

Përhëndetje zonja magjistare! Jam një vajzë, 32 –vjeçare, kam pasur një lidhje dashurie prej shtatë vitesh me një djalë që e kam dashur shumë. Por, para tre vjetësh ai është martuar dhe ka një djalë.

Mirëpo, e di se më do akoma. Kam nisur përsëri lidhjen me të, duke shpresuar se do jemi bashkë. Nuk po mund të kem lidhje me askënd tjetër pas tij... A më sheh bashkë me të?

“E nëmura”

Përgjigje:

Unë shoh se ti ke rifilluar lidhjen me njeriun që nuk të takon ty. Ti e do me zemër, por ai të do me interes dhe kjo është shumë e saktë se po të të donte ai ty nuk do të martohej me tjetrën. Të gjitha paragjykimet a iluzionet që i ke se ai të do duhet t’i largosh dhe ta gjesh fatin tënd. Mos prit që ai të

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

të bëjë zgjidhje, sepse e ka kryer jetën e vet martesore dhe, siç theti vetë, ata kanë fëmijë dhe janë bërë familje.

Çka do të ndodhë mes nesh?

Jam 25-vjeçare, e martuar, e kam një vajzë 3 vjeçe. Martesa ime po shkon shumë keq. Besoj se burri nuk është duke më dashur, sepse rri tërë kohën jashtë shtëpisë, por edhe familja e tij po e nxitë kundër meje. Dy herë jam ndarë, por hatri i vajzës jam kthyer në martesë, pasi që vajzën nuk ma jep, e unë nuk dua ta fus familjen time në probleme pse burri im nuk është i rehatshëm...

Çka të bëj, motër e nderuar, sepse jam në hall të madh?

“E penduara”

Përgjigje:

Kur është në pyetje vrazhdësia martesore, jeta është e gjatë, prandaj nuk durohet tërë jetën të jetosh me probleme. Nuk është zgjidhje të durosh dhunë vetëm për shkak të vajzës, sepse edhe po të pranosh diçka të tillë ai, me siguri, e ka mendjen të të largojë, prandaj në këso qëllime ti e humbë vlerën tënde çdo ditë e më shumë. Duhet të bisedoni... Kërko nga ai të shprehë qëllimin e vet... Dhe, konform atij qëllimi ta mbyllni problemin... Duhet të pajtoheni ose të jetoni siç u ka hije... Ose të ndaheni përgjithmonë... E, sa për fëmijën ka rregulla ligjore se kujt i takon.

Cilat shenja të horoskopit janë më naivët?



Dashi

Personat në shenjen e Dashit janë më naivë kur janë në një lidhje. Megjithëse të gjithë i paralajmërojnë që të jenë të kujdesshëm, përsëri i besojnë verbërisht partnerit të tyre.

Dashi i dashuruar do të injorojë edhe zërin e brendshëm se diçka është shumë e mirë për të qenë e vërtetë.

Gaforja

Kur Gaforret pësojnë një ndërprerje shumë të sikletshme, një grindje e dhunshme ose vdekja e një personi të dashur, kanë tendencë t'u besojnë shumë njerëzve përreth tyre.

Nëse ata njohin dikë që po kalon të njëjtën gjë, ata do të sigurohen që të mos ndihen keq dhe do të presin të njëjtën gjë nga ai person në kthim. Rezultatet shpesh i lëndojnë ata.

Bricjapi

Bricjapët gjithmonë duan të besojnë në më të mirën te njerëzit dhe kështu ata përfundojnë të mashtruar çdo herë. Bricjapët nuk duan të besojnë se ka njerëz që, thjesht, duan të përfitojnë prej tyre ose që bëjnë sikur i duan vetëm se duan diçka prej tyre.

Megjithatë, Bricjapët, të paktën, mësojnë nga gabimet e tyre.

Peshorja

Peshorja është një nga shenjat më dashamirëse dhe besohet nga të gjithë. Kjo është arsyeja pse njerëzit i shfrytëzojnë ato.

Ndonjëherë ata, gjithashtu, mund të jenë plotësisht të pavetëdijshëm për gjërat që ndodhin rreth tyre, por është mirë që mund të mësojnë nga përvojat e njerëzve të tjerë.

Shigjetari

Shigjetarët mund të jenë pak naivë, sidomos kur udhëtojnë. Ata presin që kudo njerëzit do të jenë miqësorë, por nuk është gjithmonë kështu. Ata duhet të ndalojnë së supozuari se të gjithë janë të mirë.

Peshqit

Pas çdo eksperience të keqe, peshqit i premtojnë vetes se nuk do të lejojnë më që të shfrytëzohen.

Por, për fat të keq, ata nuk i përmbahen asaj dhe shumë shpejt i lejojnë njerëzit t'i manipulojnë përsëri.



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

